



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR ”

Konsultim publik : *Banoret e Lagjes Nr.2*

Data : *27.10.2021*

Ora : *13.00*

Vendi: *Salla e Këshillit Bashkiak*

Numri i pjesëmarrësve: *Numri i pjesëmarrësve 54, nga të cilat 14 gra dhe vajza,*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Draft projekt plani buxhetor afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Kryetare e Bashkisë znj. Voltana Ademi, zv. Kryetar i bashkisë z. Ardit Çylybyli, Kryetare e Këshillit Bashkiak znj. Brisela Kadia, Kordinator për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun z. Fisnik Lutfija, Drejtor i Drejtorise Ekonomike të Arsimit Zj. Aulida Anamali, si dhe përfaqësues të drejtorive përkatëse të bashkisë Shkodër.

Takimi bashkë-drejtohet nga Kryetare e bashkisë Znj. Voltana Ademi dhe Kryetare e Këshillit Bashkiak të cilat bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjeguan qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtruan pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Udhëzuan për mënyrën e organizimit dhe mbarëvajtjes së takimit, me qëllim arritjen në përfundime dhe rekomandime konkrete për përmirësim.
- ✦ Koordinuan diskutimin ndërmjet pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me fushat e konsultuara si më poshtë vijon :

I. ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZE, i MESEM i PERGJITHSHEM, PROFESIONAL

1. **Znj. Vjollca Krymi:** Drejtoreshë e Drejtorisë nr. 1 të Koshteve
 - a) Në kopshtin “Bep Tusha” është bërë rikonstruksion i pjesshëm. Është një kopësht që ka kushte optimale. Në hyrje të kopshtit është një shesh ku parkojnë makinat prinderit, shesh që mendojmë se ka nevojë për rikualifikim (asfaltim, gjelbërim, ...)

Kopshti “Bep Tusha” ka një kaldajë të vjetër, që nuk funksionon. Ngrohja nuk është optimale. Bashkejetesa e çerdhes dhe e kopshtit është shumë e mire. Çerdhja ka rikonstruksion të plotë, që nga A-ja deri tek germa e fundit.

- b) Kopshti tek “Azem Hajdari” është në kushte optimale. Tualetet janë të përbashketa me shkollën. Nëse në ndonjë projekt të afërt mund të ndryshohet, të ndahet për t’i shërbyer vetëm fëmijeve të kopshtit.
- c) Në aneksin në kopshtin në zooteknike, kushtet janë shumë të mira. Ambjentet janë bërë shumë mirë.

Unë mund të flas për përmirësim të procesin edukativ. Në kopshtet dhe çerdhet ka nevojë që të shtohet psikologu. Ka nevojë për mesues ndihmës me kohë të pjesshëm, sepse përmirëson procesin edukativ, dhe përmirëson edhe sigurinë e jetës së fëmijes në kopsht.

2. Znj. Xhaferi: Drejtoreshë e Drejtorise së kopshtit nr. 5

Kërkoj:

- a) Kopshti Ton Alimhilli ka 132 fëmijë, ndërsa çerdhja 35 femije:
Kërkoj shtimin e ambjenteve pranë këtij kopshti me dy klasa, pasi do të na ndihmonte të kishte hapsirë më të madhe për fëmijet në këtë kopsht.
- b) Ndertimin e nje kendi lojrash per kopshtin:
- c) Kërkoj një psikolog dhe mësues ndihmës.
- d) Kërkoj ndërtimin e tualeteve;
- e) Kemi pasur një problem restaurimi në kopsht, janë marre masa dhe janë zgjidhur .
- f) Kopshti funksionon normalisht, këtë e tregon dhe numrin i femijeve që e frekuentojnë këtë kopsht.

3. Z. Sadetin Sokoli, banorë i lagjes Nr.2

- a) Unë mendoj se është domosdoshmëri që kopshtet të jenë të hapura edhe ditën e shtune.

4. Znj.Vjollca Krymi:

- a) Është e nevojshme që kopshtet të jenë hapur edhe ditën e Shtune dhe të Diele, sepse u shërben prindërve që punojnë edhe gjatë këtyre ditëve.

5. Z. Andi Halluni, anëtar i Këshillit bashkiak.

- a) Kam ardhur këtu si avokat i problematikave të lagjes Nr. 2. Mendoj se duhet të zhvendoset pikat e grumbullimit të mbetjeve tek kopshti “Tom Alimhilli”. Tek ky kopsht ka nevojë për sinjalistikë me tabele, si dhe tre katër vende parkimi që të përdoren nga prindërit që dërgojnë fëmijet në kopsht.

6. znj. Kraja:

- a) Problematikat e shkollës “Oso Kuka”: Nuk ka një palëstër të mbyllur. Gjithashtu kur është bërë rikonstruksioni i shkollës, nuk ka patur një fond riparmi për dritaret. Është diskutuar për tu shtuar një klasë informatike. Sasia e naftës e planifikuar për ngrohje është e pamjaftueshme.

7. Z.Andi Halluni:

- a) Rruga “Fahri Ramadani” duhet bërë me një sens kalimi, siç është pranë shkollës tjetër të mesme, “Jordan Misja”.

b) Tek shkolla “Skenderbeg” duhet të hiqen kontinjeret përpara shkollës.

8. Z. Lulzim Lezha:

a) Arsimi i mesëm profesional: Arsimi profesional mendoj se duhet të mbeshtetet më shumë. Në shkollën “Hamdi Bushati”, ka shume degë të mira profesionale. Të bëhet sensibilizim më i madh për të rinjtë që të ndjekin arsimin profesional pranë kësaj shkolle. Une kam bërë një marrëveshje me zyren e punës, kam nevoje për punëtoare. Shkollat profesionale i kanë kushtet shume të mira që mund të mbulojnë nevojat për punë.

9. Qytetari

a) Infrastruktura në arsim përsa i përket terreneve sportive nëpër shkolla është e mangët. Të gjithë shkollat kanë nevoj për palestra dhe paralele, në mënyrë që të zhvillohen orët e edukimit fizik sa më mirë.

10. Znj. Brunilda Dibra:

a) Kërkoj që kur të bëhet planifikimi për rikonstruksionin e shkollave, të bëhet edhe planifikimi për vendosjen e shkollave të emergjencës. Asnjë nga shkollat nuk është e pajisur me shkalla emergjence.

11. Z. Amir Topaku:

- a) Kam tre femije në tri shkolla të ndryshme, për të tre fëmijët paguaj për roje dhe bojnaxhi. Të shikohet mundësia e eliminimit të këtyre pagesave sepse nuk mund ti perballojmë.
- b) Kopshti në zooteknikë ka dalje direkte në rrugë, dhe është problem për fëmijët. Kërkoj që të vendoset sinjalistikë për rregullimin e qarkullimit.
- c) Tek shkolla “Azem Hajdari” ka nevojë për sinjalistike në hyrje të shkollës që të rregullohet qarkullimin.

II. MENAXHIMI I MBETJEVE

1. Z. Sadetin Sokoli:

a) Përsa i përket mbetjeve duhet bërë nje studim më i thelluar. Une mendoj që plehrat nuk duhet të shihen në rrugët kryesore. Ka ardhur koha që të bëhen studime më profesionale. Jemi koshient që ky lloj planifikimi ka kosto shumë të mëdha, por duhet menduar për projekte të tilla.

2. Z. Andi Halluni

- a) Ne rrugën “Hysen Lacej” kontenjerët jane gjithmonë plot. Eshtë një pike që shërben për shumë banorë.
- b) Në Dobrac nuk ka asnjë kontenjer. Propozimi im është që të shtohen pika grumbullimi mbetjesh, që jo të gjithë të vijnë në atë zonë për të tretur mbeturinat.
- c) Mendoj që do ti shërbente më mirë pastrimit, vendosja e një orari të caktuar për tretjen e mbeturinave.

3. Z.Elson Çeliku, anëtar i Këshillit Bashkiak

a) Tek rruga Hysen Lacej janë 3-4 biznese që hellin mbeturinat në kontinjerët e plehrave. A lejohen këto biznese që të hellin mbetjet këtu?

- b) Mendoj që duhet të hiqen kontinjerët e mbetjeve tek kopshti Tom Alimhilli

III. NDRICIMI RRUGOR

1. Z. Samir Drangu

- a) Rruga “Xhelil Mehmet Fishta”: Jam që në 1995 që banoj aty. Ne nuk kemi kushtet elementare. Rrugen e kemi të pa shtruar. Nuk kemi kanalizime KUZ, KUB. Aty është fusha sportive që stërvitet ekipi i Vllaznisë. Kërkoj që të jetë prioritet për investim (150 m është gjatësia e rrugës).

2. Znj. Brunilda Dibra

- a) Kërkoj që të priten lulet nga Hotel Argenti duke shkuar në drejtim të Isa Boletinit. Është një rrugë më qarkullim të lartë dhe përbejnë rrezikshmëri për kalimin e rrugës nga qytetarët.

3. Znj. Entela Mlika

- a) Rruga “Bishtiqini” është një rrugë që nuk ka ndriçim. Gjithashtu është një rrugë e amortizuar dhe ka nevojë që të asfaltohet.

4. Z. Jak Gjoni

- a) Rruga e paqes Besa Shqiptare ka nevojë që të bëhet ndriçimi rrugor. Eshtë një rrugë e ngushte dhe ka nevojë që të vendoset sinjalistike për tu bërë rrugë më kalushmëri me një sens kalimi.

5. Z. Gjelosh Kroni

- a) Rruga e Deshmoreve: Jane 10 rrugica që kanë nevojë që të asfaltohen, në total janë 1.5 km rrugë. Gjithashtu kërkoj që të investohet për vendosjen e ndriçimit në këto rrugë.

IV. RRJETI RRUGOR

1. Qytetari

- a) Jam banor i lagjes Lëvizja e Postribës, rrugica e Gilajve. Rruga është në gjëndje shumë të keqe dhe ka nevojë për investim.

2. Z. Dilaver Cufi, banor i lagjes Partizani, rruga e Golemit

- a) Kërkoj që të investohet tek rruga e Golemit sepse është tejet e amortizuar (150 m gjatësia e rrugës).

3. Qytetar

- a) Rruga e Mëndafshit është në gjendje të keqe, mungon asfaltimi, ska kanalizime të ujrave të bardha as kanalizime të ujrave të zeza (70 m është gjatësia e rrugës). Kërkoj që të shikohet me prioritet ndërhyrja në këtë rrugë.
b) Kërkoj që vërtetimi për saktësimin e adresës duhet lëshuar me shpejt.

4. Z. Azem Reka, banor i lagjes Guarrile

- a) Rruga Selim Çoba është tejet e amortizuar, kur bie shi është a pamundur që të kalojmë.

5. Z.Sadetin Sokoli

- a) Tek rruga Bujar Bishanaku, janë problem hapsirat midis pallateve. Kërkoj që të bëhet shtrimi në brëndësi të këtyre pallateve.
- b) Kërkoj që të krasiten pemët tek rruga Bujar Bishanaku sepse janë rritur shumë dhe bëhen pengesë për ndriçimin rrugor.
- c) Kërkoj që të shtrohet rruga Dervishej tek shkolla Xheladin Fishta, (është 30 m)

6. Z.Xhevat Grizhja

- a) Kërkoj që të shtrohet rrugica Ashim Kopliku, me gjatësi rreth 120 m. Une si perfaqesues i këtij komuniteti kërkoj që të shikohet me prioritet. Gjate dimrit ka shumë probleme sepse është poshtë nivelit të rrugës dhe mban shumë ujë.

7. Z.Irfan Lezha, banorë i rrugës Lekë Dugagjini

- a) Janë shumë problem ujnat e zeza tek rruga “Lekë Dugagjini”, mbas Teatrit deri në Rus. Është rrugë kryesore, dhe është bërë ndër rrugët më të këqija në Shkodër, që në sipërfaqe shikohet sa e demtuar është. Kërkoj që të investohet në këtë rrugë sepse i shërben një numri të madh banorësh.

8. Z. Maxhid Cungu

- a) Duhet të përqëndrohem tek rruga që tha z.Irfan: Është rrugë e rëndësishme sepse lidh tregun e Zdrales me tregun e Rusit. Në këtë rrugë janë të vendosura zyrat administrative të lagjes Nr.1. gjithashtu janë të vendosura disa kopshte private dhe disa institucione arsimore. KUZ dhe KUB mbete tproblem, dhe shtrimi i rrugës. Mendoj që kjo rrugë duhet planifikuar të përfshihet në buxhetin e vitit 2022.
- b) Një problem tjetër mbetet qarkullimi në këtë rrugë . Është bërë një rrugë parkimi për të gjithë, gje që pengon qarkullimin. Kërkohej që të përfshihet në kuader të rregullave të qarkullimit për të disiplinuar qarkullimin e makinave.

9. Z.Devi Kiri, banor i lagjes Skenderbeg

- a) Kërkojmë lirim të hapësirës publike në zonen e ish parkut, sepse ka gardhe, rrethime me tela të jashtë ligjshme. Është hapësirë e mjaftueshme, por asht xanë nga banore aty. Gjithasht është një zonë që ka nevojë për rehabilitimi.
- b) Kërkoj vendosjen e Bumeve ne hyrje të lagjes. Ka pas disa aksidente me pasojë vdekjen.

10. Znj.Vjollca Krymi , banore e lagjes, përballë shkollës Salo Halili.

- c) Flas në emër të banorëve, ato kërkojnë ndryshimin e emrit të kësaj rrugice. Rrugica quhet Oroshej. Nga Freskej që ka qënë, është bërë Oroshej. Ne kërkojmë që të vendoset edhe një herë rrugica Freskej sepse ka një histori shumë të bukur .
- d) Kërkojmë që të merren masa për qent e rrugës sepse janë shumë agresiv.
- e) Të vlersohet prerja e pemëve nga shkolla Salo Halili në drejtim të zukthave sepse janë rrezikshmëri për banorët. (të vleresohen pemët që janë të dëmtuara).

11. Znj.Mandija, anëtare e Këshillit Bashkiak

- a) Kërkoj që tek rruga “Nazmi Kryeziu” të vendoset sinjalistikë që pengon qëndrimin e automjeteve.

- b) Kërkoj që të shikohet mundësia për reabilitimin e sheshit para pallateve, mbrapa postës së Rusit.
- c) Të reabilitohet sheshi para kopshtit “Beb Tusha”.

12. Z.Elson Çeliku

- a) Tek sheshi në Rus, jane disa pemë shumë vjeçare. Rrenjet e tyre po i dëmtojnë trotuaret. Propozoj të asgjeshohen, të krasiten dhe të mbillen pemë tjera.
- b) Kërkoj që të ketë një reabilitim të fasadeste pallateve tek sheshi në Rus.
- c) Propozoj që rruga “Europa” të bëhet pedonale.
- d) Kërkoj që të bëhet reabilitimin tek blloku i apartamenteve në Rus. Të merret në konsideratë kërkesa jonë në mënyrë që ti shtojmë pak bukurinë kësaj zone.

13. Z.Andi Halluni

- a) Janë disa automjete që vijne nga ish komunitat, furgonat. Parkimi parkimi bëhet dysh. Kërkoj që të merren masa për këto automjete.
- b) Vizimet e vijave të bardha duhet të bëhen me bojë më cilësore, sepse ajo bojë që përdoret nuk qëndron në asfalt për një kohë të gjatë.
- c) Trotuaret bllokohen me fruta dhe perime nga ambulancat dhe njerëzit detyrohen të ecin në rrugë. Duhet të shikohet me përparësi lirim i hapsirave publike.
- d) Në të gjithë qytetin e Shkodrës, parkingjet i nxajnë me vazo dhe me karrige, asnjëri nuk paguna hapsirën e parkimit. Duhet të merren masa administrative(Gjobë) për njerëzit që xajnë parkingjet.
- e) Propozoj që panaiet që organizohen nga Bashkia, të shpërndahen edhe në lagje të qytetit. Gjithashtu propozoj që zbukurimet për festat e fund vitit të shtrihen në gjithë qytetin, dhe jo vetëm në zonat që realizohen çdo vit.

14. Z.Arban Lutfija

- a) Kërkoj që të pastrohen kanalet kulluese të rrugës Bujar Bishanaku sepse gjatë sezonit të dimrit përmytet nga rreshjet. Gjithashtu rruga Bujar Bishanaku ka nevojë që të asfaltohet ose të mirëmbahet.
- b) Kërkoj që të shikohet me përparësi ndërhyrja tek rruga nga shkolla Oso Kuka deri tek Kolegji Turk, sepse është një rrugë tejet e amortizuar.

15. Z. Elidon Dervishi

- a) Propozoj që rruga nga Sheshi Prek Cali - Sheshi Rus të bëhet rrugë me një aks kalim ose të merren masa që të eliminohet parkimi i automjeteve sepse krijohet pengesë në qarkullimin e automjeteve.

Mbajtësi i procesverbalit

Fisnik Lutfija.







Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.2

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Ornela	Okca	F	32	SHKODËR	SPECIALISTE DËDHEMIMESH	D.P. SHKODËR
2	Ardi	Hollënj	M	47	Shkodër	Jurist	Privat
3	Diondra	Kraja	F	26	SHKODËR	Poste	
4	Gilaver	Celja	M	63	Shkodër	Kasaj	Privat
5	Jasna	Ymeri	M	66	Shkodër	Menaxher	Privat
6	Arjana	Konçaj	M	65	SHKODËR	Profesor	
7	Dilbon	Shkollari	M	38	SHKODËR	Administrativ	SHPA
8	Enjtr Inja	Shkollari	M	27	SHKODËR	U-K-SH	
9	Alban Dumbaj	Shkollari	M	48	SHKODËR	PRATAP	
10	Blu	Wiktur	M	48	Shkodër	Profesor	
11	Etleva	Milica	F	41	Shkodër	Ekonomist	Interesive
12	Enja	Vlora	M	18	SHKODËR	Programues	Privat SHPA
13	Ismet	Xhofoj	M	59	SHKODËR	Pa Punë	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.2

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Ismet	BALIJAJ	MASHKULL	42	SHKODER	PUNTOR	
15	Gezim	Rekaç	MASHKULL	52	SHKODER	PUNTOR	
16	Bajram	SHKAMBERI	M.	40	SHKODËR	PRIZHARRI	
17	Mark	MULLINAJ	M	55	SHKODER	MUNICIPAL	
18	Gjok	THANI	M	60	SHKODER	MUNICIPAL	
19	Tempt Lesha	Lesha	M.	59	SHKODËR		
20	Bruno Lobo	Dibra	F.	42	SHKODER	JURISTE	Drej. Përgj. Arki
21	Devriol	KIRI	M	41	SHKODER	PA PUNË	
22	Labine	Donaj	F	51	SHKODËR	JURISTE	S.R.S.H
23	Gëzim	Kusi	M	39	SHKODËR	MËSUES	Z.V.A SHKODËR
24	Spektra	SHKUR	M	69		Pensioner	
25	Djeron	Leha	M	67			
26	Astrit	Derriishi		54	Shkoder	Kordinator	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektpanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.2

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
27	Amorjolo	Guri	M	29	Shkoder	privat	privat.
28	Elias	Kolishi	M	29	SHKODER	PRIVAT	privat.
29	Demir	Yzbej	M	29	SHKODER	PRIVAT	PRIVAT
30	Habil	Behar	M	61	Shkodër	shofer	Bashki
31	Rubin	DRANGU	M	26	SHKODER	-	-
32	Samia	DRAMU	M	58	R2/SHKODER	TREKAR	PRIVAT
33	Zoje	Mikaj	F	61	R2/HARTOBI	KUSUR	citos.
34	Shirbozer	Gjarpri	F	54	R2/SHKODER	SHKODER	SHKODER
35	ARM	BINGU	M	60	R21 SHKODER	BUYER	PRIVAT
36	Abdull	KRIZI	M	83	R2 SHKODER	SHKODER	SHKODER
37	BOY	BOGRI	M	69	R2 SHKODER	SHKODER	SHKODER
38	Edem	Celiku	M	32	R2 SHKODER	SHKODER	SHKODER
39	Enkllol	KINDA	M	30	R2 SHKODER	SHKODER	SHKODER

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.2

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
40	Zhevdan	Gjergj	semur	63	Shkollë e Përmirësimit	Shërbues Kërkimor	Sh.M.D.N.F
41	Gëzim	H. Hoxha	M.	57	Shkodër	Shërbues	Bashki Shkodër
42	Jasëkin Zekuroso	Zekuroso	M.	71	Shkodër	Pensionist	Pensionist
43	Abraham Bibini	Dibash	M.	64	Shkodër	Veç punësuar	
44	Xherret	Gjergj	M.	66	SHkodër	Pensionist	
45	Përbizem	Brahini	M.	56	Shkodër	Puntor	
46	Amir	Jondu	M.	42	Shkodër	Mëkomi	UKSH
47	Blerina	Dibra	F.	43	Shkodër	Përgjegjëse	Gerdhe
48	Yrma	Muka	F.	36	Shkodër	Përgjegjëse	Gerdhe
49	Arjeta	Xhateri	F.	42	Shkodër	Drejtorë	Faqsh
50	Marijola	Lika	F.	43	Shkodër	Mësuese	Kopesh
51	Valbona	Kreim	F.	50	Shkodër	Drejtoreshë	Kopesh - Gerdhe
52	Gërdani	Koploni	M.	25	Shkodër	Privat	Privat

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2022-2024
LAGJIA NR.2

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
53	Erindi	Sheqer	M.	23	Shkollor (Buz)	Student	—
54	Shimko	Alisa	F	41	Skenderbeg	Mesues	Administrative

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK _____